



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 777/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Arigon Sinani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Glllogoc, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Glllogoc, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa rregullt apeli i parashtruar nga Arigon Sinani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Glllogoc, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Glllogoc, me numër ZL.Anr.777/2017 i datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 09.11.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga Arigon Sinani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Glllogoc, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Glllogoc, me të cilën ka pretenduar se në qendrën e votimit nr. 0310e/03D, një vëzhgues i ka treguar se i ka pasur 4 vota, ndërsa nga rezultati përfundimtar i KQZ nuk figuron asnjë votë, po ashtu edhe në vendvotimin nr. 0303e/01R ka pasur manipulime ku në formularin e rezultateve për kandidat shihet se ka ndërhyrje në ato formularë dhe dyshon se votat e tij i janë bartur kandidatëve të tjerë.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së apelit, gjeti se:

Apeli është i pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i parashtruar nga ana e Arigon Sinani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Glllogoc, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Glllogoc, është i parregullt, sepse nuk është i nënshkruar nga parashtruesi i apelit dhe si i tillë, apeli nuk i plotëson kriteret e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 10.6, ku përcaktohet se: Apelet duhet të dorëzohen me shkrim dhe

duhet të jenë të nënshkruara nga parashtruesi i apeli apo në emër të tij nga personi i autorizuari.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozitat e lartë theksuara.

Nga arsyet e sipërshtetë të nenit 11.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL. Anr.777/2017 më datën 12.11.2017



Kryesuesja e Panelit
Gyltene Sylejmani

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*